

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

Kjo është seria e tretë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Ymer Prizreni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

BIODIVERSITETI I KOSOVËS

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshinë diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve”

E thënë me fjalë të tjera, termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larminë e organizmave të gjallë në planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv prej më se 3 miliard vjet. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “Jeta në planet”.

Ndonëse Kosova është një vend i vogël, shquhet për një biodiversitet të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor me një llojlojshmëri të mirë floristike, vegjetative dhe faunistike, ku vlen të theksohet prania e llojeve relikte, endemike si dhe të llojeve me rëndësi të veçantë. Zonat më të pasura me florë dhe faunë janë “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”. Kosova akoma nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit.




FLORA DHE VEGJETACIONI



Bazuar në hulumtimet e deritanishme në Kosovë janë inventarizuar rreth 1800 lloje të florës vaskulare, mirëpo supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në rreth 2.500 lloje.

Pra edhe më tutje nuk kemi një inventar të plotë të florës dhe vegjetacionit. Vegjetacioni i Kosovës është i përfaqësuar më 139 asociacione bimore të grupuara në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasë. Qendrat e biodiversitetit floristik në Kosovë konsiderohen “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Në kuadër të llojeve të hulumtuara rreth 200 prej tyre janë endemike, endemorelikte dhe subendemike. Sidomos është i rëndësishëm grupi i endemikëve lokal, numri i të cilëve është ende i pa definuar plotësisht (dihet për katërmbëdhjetë lloje të florës vaskulare), disa prej të cilave kanë përhapje mjaft të kufizuar. Këto lloje të endemike si dhe lloje të tjera bimore, ndër të cilat ka edhe bimë me veti mjekuese, janë të përhapura në disa pjesë të maleve të Kosovë. Vende me fito-diversitetit më të pasur konsiderohen Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna).



A E DINI SE ?

KËTO JANË DISA LLOJE BIMORE QË KONSIDEROHEN TË RRALLA DHE TË RREZIKUARA NË KOSOVË


- **Bershej i rëndomtë** / *Taxus baccata* L.
- **Bujgeri** / *Quercus trojana* Webb.
- **Vidhi i rëndomtë** / *Ulmus campestris* L.
- **Panja malore** / *Acer heldreichii* Orph.
- **Boshtra** / *Forsythia europea* Deg. Et Bald.
- **Vulfonia** / *Wulfenia carinthiaca* Jack.
- **Tulipani i Sharrit** / *Tulipa scardica* Bornm.
- **Troliusi** / *Trollius europeus* L.
- **Zambaku** / *Lilium albanicum* Gris.
- **Karafili i Sharrit** / *Dianthus scardicus* Wetst.
- **Kurorezë** / *Fritillaria graeca* Boiss. Et Sprun.
- **Bathra** / *Narcissus poeticus* L.
- **Lepjeta** / *Rumex balcanicus* Roth.
- **Asheja** / *Ilex aquilifolium* L.
- **Xerxelja** / *Daphne blagayana* Freyer.
- **Ramonda** / *Ramonda serbica* Panč.
- **Bozhuri dekorativ** / *Paeonia decera* Anders.
- **Bozhurea koraline** / *Paeonia corallina* Retz.
- **Valdestenia** / *Waldesteinia geoides* Willd.
- **Poligala** / *Polugala dorfleri* Hayek.
- **Moltkea** / *Moltkea doerfleri* Wettst.
- **Dioskora** / *Dioscorea balcanica* Koshan.
- **Rhododroni** / *Rhododendron ferrugineum* L.
- **Sanëza e verdhë** / *Gentiana lutea* L.





AKTIVITETET E EKË-KLUBIT:

TAKIMI DHE PUNTORIA I EKË-KLUBIT ME OJQ
EC MA NDRYSHE






DITA E TOKËS 22 PRILL

"22 prilli Dita e tokës" ,në IAAP "Ymer Prizreni" Prizren u mbjatën aktivitete lidhur me ruajtjen e mjedisit në nivelin global pra roli dhe ndikimi i komunitetit individ në planetin tokë.



AKTIVITET MJEDISOR

Vargëzojnë aktivitetet e njëpasnjëshme në mjediset e shkollës sonë. Nxënësit e drejtimit të "Agrobiznesit", nën udhëheqjen e mësimitdhënësve, Sefer Pulaj e Hajrije Kastrati, sot me lule e fidanë, freskuan çdo hapësirë të shkollës, duke bërë mbëltime të reja. Kështu, me këto aktivitete, shkolla po merr pamje magjike, që për nxënësit, është edhe një motiv për vullnet në mësim dhe arritje të një suksesi sa më të mirë.




AKTIVITET MJEDISOR



DITA E UJIT

Në Ditën Botërore të ujit 22 marsi, nxënësit e shkollës zhvilluan aktivitet jashtë kurrikular me mësimdhënësin Ilir Gashi, me ç'rast kanë prezantuar projektin në form posterit me temën: "Pa të s'ka jetë"!





DITA NDËRKOMBËTARE E PYJEVE

Në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve, projekti “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI) organizoi një vizitë edukativo-mjedisore për Eko Klubet e shkollave partnere të Prizrenit në Vend Gjuetinë me Rëndësi të Veçantë në Blinajë të Lipjanit. Blinaja përfshin rreth 3 mijë hektarë dhe dallohet me faunë të egër e shpezë (përfshirë kaproj, dre, derra të egër, dhelpra, shqiponja etj.), bimë të llojllojshme, e rreth 30 liqene.



EKO KLUBI "YMER PRIZRENI"

RR. IMEHMET PASHË DEVALLA, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".